



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-83
07.03.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-910/5 datë 07.03.2025, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 10-të mbajtur më 07.03.2025 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, ndalon së vlefshmi me ligj, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/7 datë 28.02.2025, miratoi Vendim PA1 nr.08-55 од 03.03.2025, me të cilën i hiqet leja për transmetim televiziv Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar me Ligj - 30 ditë

nga dita e pranimit të Faturës me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV-së, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHITEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-910/5 datë 07.03.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 10-të mbajtur më 07.03.2025, miratoi vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.